

Në bazë të nenint 18 paragrafi 1 alineja 8, neni 20 paragrafi 1 alineja 11¹, neni 31 paragrafi 3, dhe në lidhje me nenin 30 paragrafi 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 42/20 dhe 77/21), neni 15 paragrafi 1 alineja 7, neni 39 paragrafi 1 alineja 11 nga Rregullorja për punë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.ark.01-3732/1 nga 29.07.2019, dhe në lidhje me nenin 6 paragrafi 2 nga Ligji për përdorimin e gjuhëve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.7/19), në pajtueshmëri me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. ark. 02-2732/8 nga 19.07.2022, Këshili i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e tij të 26-të mbajtur më 19.07.2022, miratoi:

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E LEGJITIMACIONIT ZYRTAR E PERSONIT TË AUTORIZUAR PËR KRYERJE TË MBIKËQYRJES PROFESIONALE DHE MËNYRA E LËSHIMIT DHE HEQJES

Neni 1

Në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit zyrtar të personit të autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale dhe mënyrën e lëshimit dhe heqjes së tij, nr.ark.01-5733/1, nga 19.11.2014, preambula ndryshohet dhe thotë:

„ Në bazë të nenint 18 paragrafi 1 alineja 8, neni 20 paragrafi 1 alineja 11, neni 31 paragrafi 3, dhe në lidhje me nenin 30 paragrafi 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 42/20 dhe 77/21), neni 15 paragrafi 1 alineja 7, neni 39 paragrafi 1 alineja 11 nga Rregullorja për punë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.ark.01-3732/1 nga 29.07.2019, dhe në lidhje me nenin 6 paragrafi 2 nga Ligji për përdorimin e gjuhëve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.7/19), në pajtueshmëri me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. ark. 02-2732/8 nga 19.07.2022, Këshili i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e tij të 26-të mbajtur më 19.07.2022, miratoi:“

Neni 2

Në kreun „II. Formularë i legjitimacionit zyrtarë“, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- në nenin 3 janë bërë ndryshimet e mëposhtme:
 - fjalët: „REPUBLIKA E MAQEDONISË“ dhe fjalët: „Republika e Maqedonisë“, zëvendësohen me fjalët: „Republika e Maqedonisë së Veriut“ dhe
 - fjala „drejtor“, zëvendësohet me fjalët: „Kryetari i Këshillit“.
- Në nenin 4, në paragrafin 2 fjalët: „(„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14)“, fshihen.
- Neni 5 ndryshohet dhe thotë:

„Formulari i legjitimacionit zyrtarë për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale është pjesë përbërëse e kësaj Rregullorje edhe atë: Formulari – Shtojcë nr.1 është shtypur në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj kirilik dhe Formular – Shtojcë nr.2 është shtypur në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj kirilik dhe në gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj“.“

¹Alinetë 8 dhe 9 janë fshirë, shih: neni 8 nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.248/18).

Neni 3

Në kereun „III. Lëshimi, heqja dhe ndryshimi i legjitimacionit zyrtar“, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Në nenin 6 paragrafet 1 dhe 2 ndryshohen dhe thonë:

„Legjitimacionin zyrtarë për kryerjen e mbikëqyrjes zyrtare e lëshon Kryetari/Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Legjitimacioni zyrtarë i jepet personit zyrtarë në shërbimin profesional të Agjencisë, i cili nga ana e Kryetarit/Këshillit të Agjencisë në pajtueshmëri me kushtet e pëshkruara në nenin 31 paragrafi 1 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale është i emëruar për person zyrtar për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale të radiodifuzerëve, i cili kryhet vetëm për të përcaktuar përmbushjen e kushteve teknike në përputhje me lejen për emetim televiziv ose të radios“.

- Në nenin 7 në paragrafin 1 bëhen ndryshimet dhe plotësimet e mëposhtme:

- pas alinesë 1, lidhëza: „i“, fshihet;

- në alinen 2 shenja e pikësimit pika: „(.)“, zëvendësohet me lidhëzen:

„i“;

- pas alinesë 2 shtohet aline e re 3, e cila thotë:

„kur personi i autorizuar për të kryer mbikëqyrje profesionale do të caktohet në një vend pune në kuadër të së cilës nuk është paraparë kryerja e mbikëqyrjes profesionale, gjegjësisht lëshimi i legjitimacionit zyrtar. “.

- në nenin 8 në paragrafin 1 fjala: „drejtori“, zëvendësohet me fjalët: „Kryetari/Këshilli“.

- në nenin 10 në paragrafin 2 fjala: „drejtori“, zëvendësohet me fjalët: „Kryetari/Këshilli“.

Neni 4

Në pjesën tjetër të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit zyrtar të personit të autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale dhe mënyrën e lëshimit dhe heqjes së tij, ark.nr.01-5733/1, nga 19.11.2014, nuk ndryshon.

Neni 5

Kjo Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e identifikimit zyrtar të personit të autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale dhe mënyrën e lëshimit dhe heqjes të saja hyn në fuqi një ditë pas ditës së publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr.01-2881/1
20.07.2022
Shkup


Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
Kryetar i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO
DHE AUDIOVIZUELE

LEGJTIMACION ZYRTAR
PËR MBIKËQYRJE PROFESIONALE



Vendi për fotografinë



Emri dhe Mbiemri
PERSON I AUTORIZUAR PËR
MBIKËQYRJE RPROFESIONALE

Regj. Numër _____

Data

Shkup

v.v.

nënshkrim

(faqja e përparme)

Personi i autorizuar kryen mbikëqyrje profesionale në pajtim me autorizimin nga nenet 30, 31, 32 dhe 33 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.


Radiodifuzeri detyrohet që personit të autorizuar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes profesionale t'i mundësoje kryerjen e punës për mbikëqyrje profesionale pa pengesë.

Radiodifuzeri është i obliguar që personit të autorizuar përshkak të kryerjes së mbikëqyrjes profesionale t'i mundësojë në afatin e caktuar hyrje në hapësirat ku gjenden pajisjet dhe mjetet për sigurimin e shërbimeve mediatike dhe t'ia bëjë të dukshme dhe me kërkesë të personit të autorizuar ti japë informata, të dhëna dhe dokumente ose çfarëdo mjeti të nevojshëm për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale.

(faqja e prame)



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
АГЕНЦИЈА ЗА АУДИО И АУДИОВИЗУЕЛНИ
МЕДИУМСКИ УСЛУГИ
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



Место за
фотографија

Vendi për fotografinë

СЛУЖБЕНА ЛЕГИТИМАЦИЈА ЗА ВРШЕЊЕ НА
СТРУЧЕН НАДЗОР
LEGJITIMACION ZYRTAR
PËR MBIKËQYRJE PROFESIONALE

Име и Презиме
Emri dhe Mbiemri

ОВЛАСТЕНО ЛИЦЕ ЗА ВРШЕЊЕ НА
СТРУЧЕН НАДЗОР
PERSON I AUTORIZUAR PËR
MBIKËQYRJE RPROFESIONALE

Рег. Број _____

Рег. Numër _____

Дата

Data

Скопје

Shkup

м.п.

v.v.

потпис

nëshkrim

(предна страна)
(faqja e përparme)

Овластеното лице го врши стручниот надзор согласно овластувањата од членовите 30, 31, 32 и 33 од Законот за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги.

Personi i autorizuar kryen mbikëqyrje profesionale në pajtim me autorizimin nga nenet 30, 31, 32 dhe 33 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Радиодифузерт е должен на овластеното лице при вршење на стручен надзор да му овозможи непречено вршење на стручниот надзор.

Radiodifuzeri detyrohet që personit të autorizuar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes profesionale t'i mundësoje kryerjen e punës për mbikëqyrje profesionale pa pengesë.

Радиодифузерт е должен на овластеното лице заради вршење на стручен надзор да му овозможи во определениот рок влегување во просторија каде што се наоѓаат средствата и предметите за обезбедување на медиумски услуги и да му ги стави на увид и на барање на овластеното лице да му даде информации, податоци и документација или кои било други средства потребни за вршење на стручниот надзор.

Radiodifuzeri është i obliguar që personit të autorizuar përshkak të kryerjes së mbikëqyrjes profesionale t'i mundësojë në afatin e caktuar hyrje në hapësirat ku gjënden pajisjet dhe mjetet për sigurimin e shërbimeve mediatike dhe t'ia bëjë të dukshme dhe me kërkesë të personit të autorizuar ti japë informata, të dhëna dhe dokumente ose çfarëdo mjeti të nevojshëm për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale.

(задна страна)
(faqja e prapme)